

Monitorimi i zbatimit të ligjit për
DEKLARIMIN DHE VERIFIKIMIN E
PASURISË
SË ZYRTARËVE TË LARTË
DHE LIGJIT MBI KONFLIKTIN E
INTERESIT

Hartuar nga: QENDRA PËR TRANSPARENCËN DHE INFORMIMIN E LIRË
www.qtil.al/tirana.com
report_reporter@yahoo.com

Financuar: Ambasada Britanike, Tiranë

PRILL 2008-MAJ 2009

Përmbajtja:

- 1- Hyrje
2. Metodika
3. Prezantimi i rezultateve
4. Konkluzione
5. Propozime

Hyrje

Raporti i përgaditur nga “Watch dog” në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë përfshin kontrollin e deklarimeve të pasurisë dhe konfliktit të interesit për zyrtarët e lartë, politikanët, drejtuesit kryesorë të pushtetit lokal, gjyqtarëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe prokurorëve. Po ashtu përfshin investigimin mbi pasuritë e këtyre zyrtarëve dhe konfliktin e interesit si dhe ka matur indikatorë të tjerë jashtë deklaratës së pasurisë për të përshkruar perceptime shtesë lidhur me situatën ligjore të zyrtarëve të mësipërm.

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar duke dhënë përgjigje disa pyetjeve themelore përmes të cilave sigurohet edhe një përgjigje rreth zbatimit të dy ligjeve.

“Watch Dog”, në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informimin e Lirë, ka seleksionuar me zgjedhje të lirë rreth 3 për qind të zyrtarëve apo politikanëve të cilët janë subjekt i ligjeve të mësipërme.

Anëtarët e “Watch Dog” janë gazetarë, juristë, vlerësues pasurie dhe avokatë të çështjeve civile. Investigimi është zhvilluar përgjatë disa muajve, ndërsa projekti ka filluar në prillin e 2008-s dhe përfundoi në qershor të 2009-s.

Subjekte të zbatimit të ligjeve të mësipërm janë rreth 4500 zyrtarë të lartë apo të mesëm të administratës shqiptare. Ata janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, si dhe pozicionin që ata kanë në raport me detyrën që kryejnë në administratën publike. Ligji për deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë miratuar nga parlamenti në vitin 2003, dhe ai mbi konfliktin e interesit miratuar në vitin 2005, synojnë kontrollin e pavarur mbi administratën, kufizimin dhe identifikimin e mundshëm të rasteve të fshehjes së pasurive apo konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë.

Projekti është mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë .

Metodika

Rreth 4500 zyrtarë në të gjithë vendin janë të detyruar me ligj të deklarojnë pasurinë e tyre dhe të kontrollohen lidhur me situatat e mundshme të konfliktit të interesit.

Janë seleksionuar 24 deputetë dhe ministra ose 17 për qind e tyre; 34 zyrtarë të lartë të administratës publike, kryesisht drejtues të rëndësishëm të institucioneve, ndër ta edhe doganierë, tatimorë, regjistruer pasurie etj; 31 zyrtarë të pushtetit lokal, kryesisht kryetarë bashkie të qyteteve të mëdha apo bregdetarë si dhe komunave bregdetare apo që rrethojnë qytetet e mëdha; 30 gjykatës dhe prokurorë nga të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe akuzës ose 5 për qind e numrit total të gjykatësve dhe prokurorëve që aktualisht janë të emëruar në të gjithë vendin.

Emrat janë seleksionuar me zgjedhje të dedikuar në rastet e ministrave apo ish-ministrave, drejtuesve të institucioneve dhe atyre të pushtetit lokal ndërsa në të gjitha rastet e tjera zgjedhja është e lirë.

Janë zgjedhur një numër i madh deputetësh dhe gjykatësish për shkak se kjo kategori e zyrtarëve janë më pak të prekur nga kontrolli i detyruar që është kryer në vite prej ILDKP-së.



Përpunimi i të dhënave:

Një grup ekspertësh kanë kryer kontrollin ligjor, financiar dhe atë të pasurisë së deklaratave progresive që nga vitit 2004 e deri në 2008 dhe në një pjesë të deklaratave edhe ato të 2009. Më pas janë seleksionuar grupi i deklaratave që do të investigohen me thellë bazuar në të dhënat e përfituara nga deklaratat në tërësi. Grupi investigues ka kryer vëzhgime në terren ndërkaq ka shtuar edhe disa gjetje që nuk lidhen drejtë për drejt me detyrimin për deklarim por ndërtojnë perceptime rreth situatës ligjore të zyrtarëve. Në rastin e gjykatësve apo prokurorëve është kryer investigim mbi udhëtimet e tyre jashtë shtetit, ndërsa për të gjithë zyrtarët e seleksionuar, raporti i tyre me biznesin apo të ardhurat, para detyrës apo funksionit dhe gjatë detyrës apo funksionit.

Të dhënat janë hedhur në një database, prej së cilit janë përfiturat përgjigje të ndryshme lidhur me zbatimin ose jo të dy ligjeve.

Përzgjedhja: Nga 4500 zyrtarë që janë subjekt i deklarimit të ligjit për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë dhe atij për konfliktin e interesit, janë kontrolluar dhe investiguar 119 zyrtarë dhe politikanë.

Raporti i plotë





Plotësimi i deklaratës së pasurisë:

Gabime teknike: Kuptohet çdo shmangie nga rregullat e plotësimit të deklaratës së pasurisë. Gabimet teknike jo domosdoshmërisht çojnë në fshehje të pasurisë. Ato kryesisht shkaktohen për shkak të mungesës së përvojës dhe trajnimit të zyrtarëve për plotësimin e deklaratave. Vështirësia vjen ndër të tjera edhe për shkak se deklaratat e pasurisë nuk janë të kornizuara qartë, ku deklaruesi nuk ka nevojë të shkruajë shumë por vetëm të çekojë mbi tabelat e gatshme.


Gabime financiare: Kuptohet çdo shmangie nga detyrimi për të deklaruar vlera të pasurive të ndryshme si shtëpi, makinë, këste kredie, dhurata etj. Edhe në këtë rast gabime të tilla nuk çojnë domosdoshmërisht në fshehje pasurie por gjithsesi përbëjnë një indikacion për të kontrolluar edhe më thellë raste të tilla.


Gabimet teknike janë më të mëdha në rastet e zyrtarëve lokalë duke zënë rreth gjysmën e të gjitha gabimeve të konstatuara dhe më të vogla në rastet e zyrtarëve të administratës së lartë.








Gabime financiare ndërkaq janë më të mëdha në rastin e gjykatësve dhe prokurorëve, pra afërisht gjysma e të gjitha gabimeve dhe më pak tek zyrtarët e lartë.








Transferimi i pasurisë është tipik për gjykatësit dhe prokurorët që kanë marrë ose dhënë pasuri nga të tjerët në masën 30 për qind të gjithë numrit të tyre, ose 62 për qind të gjithë rasteve të konstatuara në të gjitha kategoritë e zyrtarëve të investiguar. Kemi raste dhurimi të vilave, apartamenteve, makinave. Deklarime për marrje borxhi në shuma të mëdha nga familjarë veçanërisht nga ata që kanë të afërm emigrantë. Në të gjitha rastet nuk është shpjeguar burimi i të ardhurave të përfituara nga transferimi apo të transferuara tek të tjerët, kryesisht vjehri, vjehrra, nëna, babai, ose vëllai.








Fshehje pasurie: Janë konstatuar raste të fshehjes së pasurisë. Bëhet fjalë për pasuri të patundshme si garazhe, troje, apartamente apo shtëpi. Por ka fshehje pasurie nëpërmjet mosdeklarimit të fitimeve nga bizneset në pronësi, uljes në vlerë të shitjeve apo blerjeve të pasurive të patundshme, marrje kredie në shuma të mëdha, interesat e të cilave nuk justifikohen nga të ardhurat, marrje kredie pa justifikuar përdorimin e saj duke lënë hapësira dyshimi edhe për pastrim parash. Po ashtu nuk ka asnjë deklaram të kutive bankare, ndërkohë që është e mundur që disa zyrtarë të kenë të tilla. Vendin e parë në fshehjen e pasurive e zënë drejtuesit lokalë.







Konflikt Interesi: Zbatimi i ligjit mbi konfliktin e interesit ka parametrat më të mira. Megjithatë ndër zyrtarët lokalë të investiguar ka tre raste të shfaqjes së konfliktit të interesit ose 10 për qind në formën e favorizimit të bizneseve private të vetë zyrtarëve ndërsa zyrtarët e lartë të administratës qendrore kemi po ashtu tre raste në formën e papajtueshmërisë së postit me biznesin privat. Ndër politikanët apo ministrat kemi vetëm një rast të këtij konflikti, një rast i kapur tri vjet më parë por ende i pakorrigjuar.






Përfshirje në biznes: Është një indikator i cili është matur për të perceptuar situatën e bizneseve të zyrtarëve dhe lidhjet e mundshme me postet e tyre në administratën publike. Më poshtë janë përqindjet e përfshirjes së zyrtarëve në biznese, e shprehur kjo si në

raport të katër kategorive të shqyrtuara sëbashku, ashtu edhe në raport mes secilës prej këtyre kategorive:







Sjellja e zyrtareve ndaj biznesit të tyre:

-filluan biznesin para emërimit ose zgjedhjes


-e filluan biznesin pasi u emëruan ose u zgjodhën


-e ndërprejnë biznesin pasi u emëruan ose u zgjodhën







Politikanët:







Zyrtarët lokalë:





Drejtësia:





Propozimet

-Që nga fillimi i zbatimit të ligjit për deklarimin e pasurisë formulari ka pësuar ndryshime, duke lehtësuar plotësimin e tij dhe të kuptuarit e kërkesave nga zyrtarët e detyruar ta plotësojnë. Me gjithë përmirësimet që i janë bërë formularit është e domosdoshme që ai të lehtësohet edhe më tej. Sa më i thjeshtë të bëhet ai, aq më lehtë plotësohet nga zyrtarët dhe aq më vështirë bëhet për këta të fundit të shmangin detyrimet e deklarimit. (Propozim i përsëritur edhe ne raportet e mëparshme).

-Qendra për Transparencë konsideron vendimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive për zgjerimin e rrethit të familjarëve të zyrtarëve me detyrim deklarimin e pasurisë si një hap të mirë për të evidentuar rastet e përfitimit apo vënies së pasurisë nëpërmjet abuzimeve apo konfliktit të interesit. Në rastin e gjykatësve dhe prokurorëve numri i tyre me raste të transferimit të pasurisë është i konsiderueshëm. Bie në sy se transferime të tilla nuk kanë logjikë financiare dhe perceptohen si një ndryshim krejt formal marrëdhëniesh të pronësisë mbi pronën me qëllim fshehjen e tyre nga detyrimi për deklarim.

Vetëm tre gjykatës apo prokurorë kanë deklaruar shtëpi verore në bregdet ndërkohë që të dhënat e përgjithshme të marra nga kompanitë ndërtuese në zonat turistike flasin për një klientelë shumë të zgjeruar nga radhët e gjykatësve e prokurorëve. Pasuri të tilla ose janë informale dhe të paregjistruara në hipoteka ose janë transferuar te të afërmit e tyre.

-Zyrtarët lokalë janë të përfshirë në një masë të madhe në biznese private që zhvillohen në territorin ku ata kryejnë detyrat publike. Këtë biznes pjesërisht e kanë në konflikt interesi me shërbimet që ata ofrojnë për qytetarët dhe pjesërisht vetë biznesi i ndihmon ata për të bërë karrierë në politikën lokale. Pas marrjes së postit të tyre ata nuk janë ndarë nga ato biznese, nuk deklarojnë të ardhura korrekte për biznesin që ata kryejnë. Kjo shton mundësitë e abuzimit të tyre me pushtetin që zotërojnë. Për kryetarët e komunave dhe bashkive me zhvillim të madh urban apo turistik, ILDKP të zhvillojë kontroll të veçantë dhe sistematik.

-Ka raste të marrjes së kredive pa justifikim çfarë do të thotë se është e nevojshme një bashkëpunim për raste të tilla me drejtorinë e luftës kundër pastrimit të parave.

-ILDKP duhet të ndryshojë mënyrën e hedhjes së shortit të kontrollit të zyrtarëve duke i ndarë ata në kategori. Kjo mund të shtojë procedurat e hedhjes së këtij shorti por kontrolli në këtë rast mund të jetë më i qarkullueshëm tek të gjithë llojet e zyrtarëve. Megjithatë hedhja e shortit nuk duhet të shmangë principin e tij të zgjedhjes së lirë, ashtu siç është tani.

- Inspektorët e ulët në administratë të emërohen nga Inspektorati i Lartë dhe të jenë të pavarur nga ministria apo institucioni ku ata do të atashohen. Inspektorët e ulët nuk duhet të kryejnë punë tjetër në institucion siç është praktika deri tani ku drejtorë të administratës shërbejnë edhe si inspektorë. Kjo, për shkak se ata paguhen keq, kanë konflikt interesi me shefat e tyre, nuk e kryejnë mirë punën dhe nuk kryejnë seanca trajnimi me zyrtarët për plotësimin e formularit.

-Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive duhet të shtojë numrin e gjykatësve dhe prokurorëve në listën e përvitshme të personave që kontrollohen. Kjo mund të behet e mundur duke ndryshuar mënyrën e hedhjes së shortit.

-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të kontrollojë deklaratat e pasurisë së gjykatësve dhe ta përfshijë kontrollin e saj në të gjitha rastet e transferimit, emërimeve apo ngritjeve në detyrë.

-Edhe Ministria e Drejtësisë duhet të përfshijë në detyrat e kontrollit të kësaj ministrie kontrollin e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- ILDKP duhet të kërkojë deklarimin e kutive të sigurisë për ata që disponojnë të tilla, dhe ky lloj deklarimi të shtohet në ligj.

Konkluzionet

Grupi “Watch dog” ka kontrolluar dhe verifikuar 119 deklarata të zyrtarëve nga rreth 4500 zyrtarë në të gjithë vendin që janë të detyruar me ligj të deklarojnë pasurinë e tyre dhe të kontrollohen lidhur me situatat e mundshme të konfliktit të interesit. Janë seleksionuar 24 deputetë dhe ministra ose 17 për qind e tyre; 34 zyrtarë të lartë të administratës publike, kryesisht drejtues të rëndësishëm të institucioneve, ndër ta edhe

doganierë, tatimorë, regjistruer pasurie etj; 31 zyrtarë të pushtetit lokal, kryesisht kryetarë bashkie të qyteteve të mëdha apo bregdetarë si dhe komunave bregdetare apo që rrethojnë qytetet e mëdha; 30 gjykatës dhe prokurorë nga të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe akuzës ose 5 për qind e numrit total të gjykatësve dhe prokurorëve që aktualisht janë të emëruar në të gjithë vendin.

Emrat janë seleksionuar me zgjedhje të dedikuar në rastet e ministrave apo ish-ministrave, drejtuesve të institucioneve dhe atyre të pushtetit lokal ndërsa në të gjitha rastet e tjera zgjedhja është e lirë.

Janë zgjedhur një numër i madh deputetësh dhe gjykatësish për shkak se kjo kategori e zyrtarëve janë më pak të prekur nga kontrolli i detyruar që është kryer në vite prej ILDKP-së.

Në seleksionim është mbajtur parasysh që asnjë prej anëtarëve të “Watch dog” të mos ketë konflikt interesi me të përzgjedhurit.

Ky është “Watch dog” i tretë lidhur me verifikimin e pasurive të zyrtarëve, që kur ka filluar implementimi i ligjit të deklarimit të pasurisë në vitin 2003. Kontrolli është bërë mbi deklaratat progresive, pra për të gjitha deklaratat dhe ndryshimet e tyre përgjatë viteve 2003-2008 (për të gjithë ata që e kanë pasur këtë detyrim përgjatë katër viteve). Nga një analizë krahasuese mes tre raporteve konstatohet se zyrtarët në përgjithësi kanë rritur vlerësimin për momentin e deklarimit, me përjashtim të zyrtarëve lokalë. Ka në shumë raste deklarime model dhe të besueshme. Për shembull disa prej gjykatësve që në deklaratat e viteve të para pothuajse nuk kishin deklaruar as rrogën, në deklarimin e fundit janë mjaft seriozë.

Ndërkaq ndryshe nga të gjitha deklaratimet e mëparshme është shtuar numri i fëmijëve të zyrtarëve që sjellin deklaratimet e tyre në ILDKP. Deklarimet janë të detajuara dhe inspektorët e ILDKP-së apo ekspertët e QTIL e kanë shumë më të lehtë të operojnë përgjatë kontrollit.



Puna e Inspektoratit të Lartë të Pasurive është e lavdërueshme. Ai ka kërkuar në disa raste procedimin nga prokuroria për shkelje të ligjit të deklarimit të pasurisë.

Vazhdon mosdeklarimi i pasurive informale, mosdeklarimi i bilanceve për ata që kanë biznese private, ose kur këto të fundit deklarohen, referencat janë negative (vërejtje e bere ne te tre raportet).


ANEX

RAPORTI PËR ZYRTARËT E DREJTËSISË (PUBLIKUAR NË JANAR 2008)

Përzgjedhja: Nga 646 gjykatës dhe prokurorë janë seleksionuar për kontroll 30 prej tyre ose 5% e numrit total. Brenda këtij grupi janë rreth 7% e të gjykatësve dhe 2% e numrit total të prokurorëve.




raporti mes gjykatësve dhe prokuroreve të investiguar



68 për qind e gjykatësve të kontrolluar punojnë në gjykatat e Tiranës ndërsa 32 për qind në gjykatat e rretheve. Prokurorët janë të gjithë të punësuar në Tiranë me përjashtim të një rasti.

Shpërndarja e gjykatësve





Plotësimi i deklaratës së pasurisë:

Gabime teknike: Kuptohet çdo shmangie nga rregullat e plotësimit të deklaratës së pasurisë. Gabimet teknike jo domosdoshmërisht çojnë në fshehje të pasurisë. Ato kryesisht shkaktohen për shkak të mungesës së përvojës dhe trajnimit të zyrtarëve për plotësimin e deklaratave. Vështirësia vjen ndër të tjera edhe për shkak se deklaratat e pasurisë nuk janë të kornizuara qartë, ku deklaruesi nuk ka nevojë të shkruajë shumë por vetëm të çekojë mbi tabelat e gatshme.

Gabime financiare: Kuptohet çdo shmangie nga detyrimi për të deklaruar vlera të pasurive të ndryshme si shtëpi, makinë, këste kredie, dhurata etj. Edhe në këtë rast gabime të tilla nuk çojnë domosdoshmërisht në fshehje pasurie por gjithsesi përbëjnë një indikacion për të kontrolluar edhe më thellë raste të tilla.

Gabimet teknike janë më të vogla në rastet e gjykatësve 15% ndërsa në rastin e prokurorëve 20%. Ndërkaq gabimet financiare rëndojnë tek gjykatësit në 36% të të kontrolluarve ndërsa për prokurorët 20 %.







Fshehje pasurie:

Janë konstatuar raste të fshehjes së pasurisë. Bëhet fjalë për garazh, truall dhe apartament.

Transferim pasurie, hua, dhurate: Ky është momenti më i dukshëm i fshehjes së abuzimit të zyrtarëve. Kemi dhurim vilash, apartamentesh, makinash. Deklarime për marrje borxhi në shuma të mëdha nga familjarë veçanërisht nga ata që kanë të afërm emigrantë. Në të gjitha rastet nuk është shpjeguar burimi i të ardhurave të përfituara nga transferimi apo të transferuara tek të tjerët, kryesisht vjehri, vjehrra, nëna, babai, ose vëllai.







Konflikt interesi: Nuk është konstatuar konflikt interesi përgjatë deklaramëve të zyrtarëve të drejtësisë. Vetëm në një rast konstatohet një konflikt i perceptuar interesi, ose në total në 3% të gjithë zyrtarëve të drejtësisë.

Gjendja imobilare: Janë matur rastet me **nje apartament; 2 apartamente; vile; biznes etj**

Kjo ndihmon që të perceptojmë situatën sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar mbi deklaratat e tyre të pasurisë.

Shumica e zyrtarëve të drejtësisë jetojnë në një apartament, më pak kanë dy apartamente, si dhe më pak kanë vila. Nga grafiku i parë bie në sy që prokurorët janë edhe më të “rehatuarit” nga pikëpamja e banesave, ndërkaq gjyqtarët kanë më shumë biznese të cilat drejtohen nga burri ose gruaja që nuk janë gjykatës, ose janë rrjedhim i trashëgimisë.

Shpesh deklarimi i pasurisë së tyre është mjaft strikt: Një gjyqtar ka deklaruar aksione ndërsa një tjetër ka deklaruar kompensimin që merr nga shtetit për bukë, ndërkaq një tjetër ka deklaruar edhe një sasi të madhe eurosh të transferuara në llogarinë e tij e më pas të shkarkuara pasi i duheshin si garanci për një vizë.



Udhëtimet jashtë vendit ne periudhat 2005, 2006, 2007, 2008

Kjo është një matje që është realizuar krejtësisht nga grupi i gazetarëve të përfshirë në “Watch dog”, pasi të dhënat nuk janë përfituar nga deklaratat e pasurisë por nëpërmjet kërkimeve të gjata e të vështira të gazetarëve. Qëllimi është të krijohet një panoramë sa

më e qartë e situatës sociale të zyrtarëve të drejtësisë, pavarësisht se të dhëna të tilla nuk përfshihen në detyrimin ligjor të deklarimit të pasurisë.


Sipas të dhënave të mara nga disa gjykata, një gjykatës mund të udhëtojë zyrtarisht jashtë shteti jo më shumë se 1 ose 2 herë në vit, dhe kjo për një numër të vogël gjyqtarësh.


Ndërkaq udhëtimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas viteve janë: në 2005- 84, në 2006-119, në 2007- 134, në 2008- 118

Referuar shifrave të mësipërme i takon që çdo gjyqtar ose prokuror ka udhëtuar afërsisht tre herë jashtë shtetit në vitin 2005, afërsisht katër herë në 2006, afërsisht pesë herë në vitin 2007, dhe katër herë në vitin 2008.

Ka gjyqtarë të cilët nuk kanë udhëtuar asnjëherë siç ka gjyqtar që brenda një viti ka udhëtuar jashtë vendit, me makinë ose avion 46 herë ose ndryshe çdo javë.


Në fluksin e udhëtimeve më frekuentët janë gjykatësit se sa prokurorët.






Po çfarë zgjedhin për udhëtim zyrtarët e drejtësisë:

- Me avion 117 ose 15%
- Me makine ose traget 637 ose 84 %
- Me autobus 3 ose 1%








Pushimet jashtë për 2007 dhe 2008

Matja është bërë vetëm për vitin 2007 në të cilin 32 % e gjykatësve dhe prokurorëve i bënë pushimet jashtë ndërsa 68% i bënë ato në Shqipëri.

Në 2008 ka një rritje të numrit të pushuesve jashtë. Nëse në 2007 kanë bërë pushimet jashtë 8 gjykatës dhe prokurorë, në 2008 kanë bërë pushimet jashtë 11 gjykatës dhe prokurorë. Ndryshe në 44 % të rasteve pushuan jashtë vendit ndërsa në 56% ishin në Shqipëri.



2008 ku i bene pushimet



Për festat e fundvitit ata janë më dorështrënguar. Në vitin 2007 në 24 % të rasteve ata kanë festuar jashtë ndërsa 76% në vend.

2007, festat e fundvitit

